Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1.7 i Ligjit nr. 03/l-060 për Kualifikimet Kombëtare, zv. Drejtori i AKK: miraton këtë:

RREGULLORE NR.01/2026 PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR MONITORIMIN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë fushëveprimin, kriteret, llojet e monitorimit procedurat e zbatimit të monitorimit, mënyrën e raportimit si dhe masat dhe veprimet e tjera për monitorimin e IAAP dhe Institucioneve tjera, nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), për të përmirësuar cilësinë përmes monitorimit të vazhdueshëm, mbështetjes për përmirësim, si dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, por edhe duke u bazuar në rekomandimet që dalin nga procesi i akreditimit dhe validimit të cilat i realizon AKK.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ndaj Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) dhe institucioneve tjera të cilat janë të akredituara\ri akredituara dhe validuara\ri validuara nga AKK.

Neni 3
Përkufizimet dhe shkurtesat

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
   1.1. **Aprovimi** - nënkupton procesin përmes të cilit Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, njeh kualifikimet, cakton kuotat, afatet dhe kreditë kur është e aplikueshme. Kualifikimi duhet ti nënshtrohet riaprovimit nga ana e AKK, bazuar në procedurat e caktuara.
   1.2. **Akreditimi** - nënkupton procesin përmes të cilit Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), i themeluar me këtë ligj, përcakton institucionet që vlerësojnë kandidatët dhe lëshojnë certifikata dhe diploma (institucionet e vlerësimit) dhe çdo organ tjetër që kryen funksione të tjera në emër të AKK. Institucionet e akredituara duhet të jenë objekt i monitorimit dhe auditimit nga AKK.
   1.3. **Arsimi dhe aftësimi profesional (AAP)** - synon të pajisë nxënësit/kandidatët me njohuri, aftësi praktike, shkathtësi dhe kompetenca të kërkuara në profesione të veçanta apo më gjerë në tregun e punës;
   1.4. **Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)** - është agjenci e themeluar për të zhvilluar kornizën kombëtare të kualifikimeve dhe për të rregulluar sistemin kombëtar të kualifikimeve
   1.5. **Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP)** - institucion publik ose privat që zbaton programe të arsimit dhe aftësimit profesional, apo kualifikime të caktuara në pajtim me KKK;
   1.6. **Institucionet e tjera**-Institucionet që përveç IAAP ofrojnë arsim dhe aftësim profesional dhe janë të akredituara;
   1.7. **KKSC**-Korniza Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë;
   1.8. **KD AKK**-Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve;

1.9. **Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK)** - mekanizëm kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve të dhëna brenda sistemit kombëtar të kualifikimeve, sipas grupit të kriterit që përcaktojnë nivelet dhe llojet e rezultateve të mësimit;

1.10. **Monitorimi** – proces formal i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve për të verifikuar nëse institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional vazhdojnë të përmbushin rekomandimet e vlerësuesve të jashtëm dhe kushtet e akreditimit/riakreditimit dhe të validimit/ri-validimit.

1.11. **Njohja e Mësimit Paraprak** (NjMP) - nënkupton procesin e vlerësimit të njohurive, shkathtësive ose kompetencave më të gjëra, të cilat një individ i ka arritur më herët, nëpërmjet mësimit formal, joformal ose informal. Kjo njohuri praktike do të shfrytëzohej për ti dhënë mundësi individit që të avancohet ose të lirohet për një pjesë të kualifikimi ose kredisë drejt kualifikimit.

1.12. **Raporti i vetëvlerësimit (RVV)** – Raport të cilin obligohen për ta sjellë institucionet që aplikojnë për akreditim dhe validim.

2. Në kuptim të zbatimit të kësaj rregulloreje, në të gjitha rastet kur përdoret termi akreditim dhe validim nënkuptohet edhe procesi i ri akreditimit dhe ri validimit, kur është i aplikueshëm, pa pasur nevojë të përsëritet në secilën dispozitë në mënyrë të ndarë.

3. Të gjitha shkurtesat dhe terminologjia e përdorur në këtë rregullore që nuk janë sqaruar në këtë nen kanë kuptimin si në përkufizimet në ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse që zbatohen në këtë proces.

4. Monitorimi si proces organizohet për të gjitha institucionet, shkollat, akademitë, institutet etj., që akreditohen/ri akreditohen, validohen/ri validohen dhe atyre që ju njihen kualifikimet dhe ju lëshohen Certifikatat apo diplomat në cilëndo mënyrë nga AKK.

5. Në kuptim të zbatimit të kësaj rregulloreje, në të gjitha rastet kur përdoret termi "akreditim" dhe "validim", nënkupton edhe termin "ri akreditim" dhe "ri validim", pa pasur nevojë të përsëritet në secilën dispozitë të kësaj rregulloreje.

Neni 4
Procesi i monitorimit nga AKK

1. Procesi i monitorimit ka për qëllim të verifikojë, në mënyrë të dokumentuar, përputhshmërinë e ofruesve të akredituar të IAAP-së dhe ofruesve të tjerë me kriteret dhe standardet e përcaktuara. Procesi i monitorimit siguron që mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë në IAAP janë të qëndrueshëm ose të përmirësueshëm dhe konfirmon përmbushjen e kushteve mbi të cilat institucioni është akredituar dhe validuar.
2. Monitorimi realizohet në proceset pas akredituese.
3. Zbatimi i procesit të monitorimit të IAAP nga AKK përcaktohet me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060 nenet 18 dhe 19. Procesi i monitorimit, po ashtu zbatohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, të cilat në mënyrë të qartë përshkruajnë kërkesat e përputhshmërisë për IAAP të cilët duhet të monitorohen nga AKK.
4. AKK ka të drejtën e rezervuar të monitorimit të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional të cilat janë akredituar dhe validuar, sipas rregullave në fuqi. Monitorimi pas

akreditimit është proces i rregullt i cili realizohet në çdo kohë, me ose pa paralajmërim, sipas vlerësimeve dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.

5. Procesi i monitorimit të IAAP dhe institucioneve të tjera vlerëson:
   5.1. Përmbushjen e kushteve të akreditimit dhe validimit të IAAP dhe institucioneve të tjera;

   5.2. Përmbushjen e rekomandimeve nga procesi i akreditimit dhe validimit, saktësinë e dëshmive të prezantuara nga IAAP dhe institucioneve të tjera në procesin e akreditimit dhe validimit;

   5.3. Verifikimin e stafit mësimdhënës, listat e pjesëmarrësve në trajnime dhe mësim, përputhshmërinë e infrastrukturës për zhvillimin e procesit mësimor apo praktik, plan programin mësimor, oraret si dhe çështje të tjera të ndërlidhura me kushtet e akreditimit dhe validimit;

   5.4. Verifikimin e dëshmive duke përdorur mostrat e përzgjedhura nëpërmjet portfolieve të kandidateve;

   5.5. Kontrollimin e ndryshimeve nga IAAP dhe institucionet e tjera dhe përputhjen e vazhdueshme me kriteret e AKK; (pronësinë e IAPP, emërtimin, stafin udhëheqës, koordinatorin për Sigurim të Cilësisë (SC), stafin mësimdhënës/trajnerë etj.);

   5.6. Kontrollimin e ndryshimeve të IAAP dhe institucioneve tjera si dhe përputhjen e vazhdueshme me kriteret e AKK, në raport me kualifikimet/modulet, orët/kreditë, hapësirat dhe pajisjet, kriteret dhe format e vlerësimit;

6. Monitorimi nga AKK synon që të sigurojë që kriteret e përcaktuara nga procesi i validimit të kualifikimit dhe akreditimit të institucionit janë në përputhje dhe zbatohen në mënyrë korrekte nga IAAP i cili ka akreditim valid, bazuar në vendimin e AKK dhe raportin e ekipit të ekspertëve.
7. Procesi i monitorimit realizohet nga Njësia e Monitorimit, në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në AKK, e cila ushtron kompetencat përkatëse në përputhje me rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të AKK-së. Në rastet kur vlerësohet e nevojshme, procesi i monitorimit mund të realizohet edhe nga ekipet e ekspertëve të jashtëm, të angazhuar dhe të koordinuar nga zyrtarët e AKK-së, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
8. Procesi i monitorimit ofron qasje mbështetëse dhe këshillëdhënëse për IAAP-të për veprime proaktive dhe efektive që duhet të ndërmerren për të siguruar cilësinë në institucione si dhe u mundëson IAAP-ve përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.
9. Procesi i monitorimit bazohet në një qasje gjithëpërfshirëse dhe të standardizuar, që përfshin: shqyrtimin e dokumentacionit, vlerësimin në vend, intervistat me stafin dhe kandidatët, dhe analizimin e treguesve të performancës.
10. AKK garanton mbrojtjen e privatësisë dhe konfidencialitetit për të gjithë personat e intervistuar dhe sinjalizuesit, në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.

11. AKK realizon procesin e monitorimit si pjesë e procedurës pas-akredituese, përkatësisht pas dhënies së akreditimit dhe/ose validimit për IAAP-të dhe institucionet e tjera përkatëse.

Neni 5
Parimet e procesit të monitorimit nga AKK

1. Procesi i monitorimit i IAAP nga AKK, synon që të mbikëqyrë zbatimin e objektivave që kanë qenë rezultat i procesit të akreditimit.

2. Procesi i monitorimit bazohet në disa parime të rëndësishme, të cilat zbatohen nga ana e AKK, si vijon:
   2.1. **Parimin e ligjshmërisë** - që nënkupton të bazuarit dhe punën e AKK, në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi;

   2.2. **Parimin e objektivitetit** - që nënkupton veprimin e AKK në këtë proces, sipas kritereve objektive dhe të matshme për të gjitha IAAP e akredituara dhe validuara;

   2.3. **Parimin e transparencës** - që nënkupton zhvillimin e procesit të monitorimit nga AKK në mënyrë të hapur, të bazuar në prova dhe fakte të dokumentuara. Për garantimin e transparencës, gjurmueshmërisë dhe dokumentimit të çdo faze të monitorimit, të gjitha raportet e monitorimit, përfshirë raportet e rregullta dhe pasuese, arkivohen në sistemet digjitale dhe fizike të menaxhuara nga AKK, me qasje të përcaktuar për institucionin përkatës dhe palët e autorizuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

   2.4. **Parimin e përmirësimit të vazhdueshëm** - që nënkupton të drejtën dhe mundësinë e çdo IAAP të akredituar dhe validuar për të ndërmarrë masa përmirësuese, bazuar në kërkesat, gjetjet dhe rekomandimet që dalin nga AKK gjatë procesit të monitorimit;

   2.5. **Parimin e mos diskriminimit** - që nënkupton zbatimin e një qasjeje të barabartë dhe të paanshme nga AKK ndaj të gjitha IAAP-ve, pa asnjë formë diskriminimi, gjatë vlerësimit dhe zbatimit të kërkesave dhe kritereve të monitorimit;

   2.6. **Parimi i proporcionalitetit** – që nënkupton përshtatjen e intensitetit, shtrirjes dhe metodave të monitorimit në përputhje me nivelin e rrezikut, madhësinë e institucionit dhe natyrën e shkeljeve të identifikuara ose të mundshme;

   2.7. **Parimi i konfidencialitetit** – që nënkupton mbrojtjen e të dhënave dhe informatave të ndjeshme të kandidatëve, stafit dhe institucionit, përveç kur kërkohet ndryshe nga ligji.

   2.8. **Parimi i paanësisë** – që nënkupton se të gjithë monitoruesit dhe ekspertët veprojnë pa ndikime të jashtme dhe pa konflikt interesi.

   2.9. **Parimi i aplikimit të diskrecionit në mënyrë të arsyeshme** - që nënkupton marrjen e vendimeve nga AKK në bazë të vlerësimit profesional, të arsyetuar dhe

proporcional, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rrethanat konkrete të secilit rast.

2.10. Shkelja e parimeve të përcaktuara në këtë nen përbën bazë për paraqitjen e ankesës nga palët e interesuara, përkatësisht nga IAAP, në kuadër të procesit të monitorimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6
Detyrimet e institucioneve të akredituara

1. Institucionet e akredituara janë të detyruara të njoftojnë me shkrim Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) për çdo ndryshim thelbësor që ndikon në funksionimin institucional dhe në cilësinë e ofrimit të kualifikimeve. Njoftimi duhet të bëhet brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh pune nga data e marrjes së vendimit përkatës për ndryshim. Këto përfshijnë:

   1.1. Ndryshimi i pronësisë së institucionit;
   1.2. Ndryshimi i emrit të institucionit;
   1.3. Ndryshimi i stafit udhëheqës të institucionit (drejtor, udhëheqës, etj.);
   1.4. Ndryshimi i koordinatorit për sigurimin e cilësisë;
   1.5. Ndryshimi i kontratave, përbërjes ose statusit të stafit mësimdhënës;
   1.6. Ndryshime në infrastrukturë që ndikojnë në ofrimin e programit;
   1.7. Ndryshime në kohëzgjatjen, vendndodhjen apo përmbajtjen e kualifikimit të validuar;
   1.8. Inicimi i ndonjë procedure ligjore ndaj institucionit apo stafit të tij;
   1.9. Çdo pengesë e hasur në përmbushjen e standardeve të cilësisë.

2. Në rast të dyshimeve apo konstatimeve për shkelje të mëposhtme, AKK mund të ndërmarrë proces të rregullt ose të jashtëzakonshëm të monitorimit:

   2.1. Zbatimi i papërshtatshëm i procedurave të vlerësimit dhe certifikimit;

      2.1.1. Mungesë evidencash për vlerësim dhe përdorimi i testeve të papërputhshme me kërkesat e kualifikimit;
      2.1.2. Tejkalim i numrit të grupeve dhe numrit të kandidatëve brenda grupit;
      2.1.3. Mungesë e dokumentar e regjistrimeve të dosjeve të kandidatëve dhe procesit mësimor/trajnues.

   2.2. Staf jo i kualifikuar ose i paangazhuar në mënyrë të rregullt:
      2.2.1. Angazhimi i stafit pa kontratë të dokumentuar;
      2.2.2. Staf i papërshtatshëm për nivelin e kualifikimit;
      2.2.3. Mungesë e stafit në aktivitetet mësimore/trajnuese të planifikuara.

   2.3.Infrastrukturë dhe pajisje jo të përshtatshme për zhvillimin e programit
      2.3.1. Pajisje të dëmtuara ose jofunksionale;
      2.3.2. Mungesë e qasjes së kandidatëve në ambientet praktike;
      2.3.3. Mospërputhje ndërmjet programit të miratuar dhe zbatimit në praktikë.

3. Vizitat monitoruese për pikat e Nenit 6 realizohen sipas nevojës, në varësi të njoftimeve apo kërkesave.

4. Në rast se iniciohet proces i monitorimit me ekspertë të jashtëm, kostot përkatëse të procesit mbulohen nga institucioni.

Neni 7
Llojet e monitorimit që zbatohen nga AKK

1. Për të realizuar zbatimin e kësaj rregulloreje, AKK zbaton këto procese të monitorimit:
   1.1. Monitorimi përmes dorëzimit të raportit të vetëvlerësimit dhe planit të përmirësimit nga IAAP (realizohet nga njësia përkatëse e AKK-së, me mundësi për përfshirjen e ekspertëve të jashtëm kur është e nevojshme);
   1.2. Monitorimi nga stafi i AKK-së;
   1.3. Monitorimi nga ekspertë të jashtëm të angazhuar nga AKK;
   1.4. Monitorimi i certifikatave/diplomave të lëshuara nga IAAP (realizohet nga stafi i AKK-së, me mundësi për përfshirjen e ekspertëve të jashtëm kur kërkohet verifikim i specializuar);
   1.5. Monitorimi nëpërmjet deklarimit të kandidatëve dhe grupeve.

2. Monitorimet që realizohen nga AKK, nga pika 1.2, 1.3 dhe 1.4, mund të bëhen me paralajmërim dhe pa paralajmërim.
3. Të gjitha llojet e monitorimeve nga AKK zbatohen në bazë të një dinamike të arsyeshme që respekton të drejtat e të gjitha IAAP, si persona juridik, me përjashtim të monitorimit pa paralajmërim.

Neni 8
Kriteret e fillimit të procesit të monitorimit

1. AKK mund të fillojë procesin e monitorimit ndaj IAAP-ve dhe institucioneve të tjera bazuar në kriteret vijuese:
   1.1. Monitorimi me kërkesë të KD-AKK;
   1.2. Akreditimi/Validimi me kusht;
   1.3. Numri i rekomandimeve të dhëna për institucionin;
   1.4. Ankesat dhe sinjalizimet nga palët;
   1.5. Ndryshimi i hapësirave/lokacionit të institucionit dhe ndryshimet e tjera në procesin e post akreditimit/validimit;
   1.6. Mos deklarimi i grupeve dhe kandidatëve;
   1.7. Moszbatimi i gjetjeve nga procesi i monitorimit;
   1.8. Monitorimi bazuar në veprimet e sipas detyrës zyrtare të AKK, sipas kësaj rregulloreje.
2. Stafi i AKK-së, përkatësisht njësia përgjegjëse për monitorim, në bazë të kritereve të përcaktuara për inicimin e procesit të monitorimit, harton listën e institucioneve që do t'i nënshtrohen këtij procesi.
3. Të gjitha kriteret e monitorimit, të përcaktuara në këtë nen, zbatohen përmes llojeve të monitorimit që i përcakton neni 6 i kësaj rregulloreje.

Neni 9
Afatet e monitorimit, procesi dhe mënyra e inicimit

1. Të gjitha llojet e monitorimit realizohen sipas afateve të veçanta dhe zhvillohen në përputhje me një proces të strukturuar, i cili përfshin këto faza:
   1.1. inicimin dhe zhvillimin e procesit të monitorimit;
   1.2. grumbullimin dhe shqyrtimin e dokumenteve dhe dëshmive që dalin nga procesi i monitorimit;
   1.3. hartimin e raportit të monitorimit me të gjeturat përkatëse;
   1.4. paraqitjen e komenteve nga IAAP në raportin e monitorimit;
   1.5. shqyrtimin e raporteve nga Këshilli Drejtues i AKK-së, në rastet kur raportet paraqiten për vendimmarrje;
   1.6. ushtrimin e së drejtës së ankesës nga institucioni, pas nxjerrjes së vendimit nga Këshilli Drejtues i AKK-së.

2. Monitorimi përmes dorëzimit të raportit të vetëvlerësimit dhe planit të përmirësimit nga IAAP-të dhe institucionet e tjera realizohet si vijon:

   2.1. Për ofruesit e aftësimit profesional (qendrat trajnuese), monitorimi mbulon periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit përkatës dhe iniciohet sipas detyrës zyrtare nga AKK.
   2.2. Për ofruesit e mësimit të kombinuar, monitorimi mbulon periudhën nga 1 shtatori deri më 31 gusht të vitit shkollor përkatës.

3. Pas përfundimit të periudhave të përcaktuara në paragrafët 3.1 dhe 3.2 të këtij neni, IAAP-të dhe institucionet e tjera janë të obliguara të dorëzojnë Raportin e Vetëvlerësimit (RVV) brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh, duke filluar nga dita e fundit e përfundimit të periudhës përkatëse.

4. Monitorimi nga stafi i AKK-së mund të realizohet me paralajmërim ose pa paralajmërim, në përputhje me këtë rregullore. Inicimi i këtij lloji të monitorimit bëhet nga stafi i AKK-së, përkatësisht nga njësia përgjegjëse për monitorim, bazuar në gjetjet e dala nga monitorimi përmes Raportit të Vetëvlerësimit, si dhe në informacione ose sinjalizime të pranuara nga palë të jashtme.

5. Në rast se monitorimi nga stafi i AKK-së realizohet me paralajmërim, IAAP njoftohet me shkrim të paktën 3 (tre) ditë përpara datës së caktuar për vizitën monitoruese.

6. Raporti i monitorimit hartohet dhe i dorëzohet Drejtorit të AKK-së jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të vizitës monitoruese nga stafi i AKK-së. Raporti i përcillet edhe IAAP-së përkatëse, e cila ka të drejtë të paraqesë komente me shkrim brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh nga data e pranimit të raportit.

7. Monitorimi përmes ekspertëve të angazhuar nga AKK mund të iniciohet vetëm në rastet kur AKK vlerëson se IAAP cenon në mënyrë serioze kushtet e akreditimit dhe validimit. Inicimi i këtij lloji të monitorimit bëhet sipas detyrës zyrtare nga AKK, përkatësisht nga

njësia përgjegjëse për monitorim, ose mbi bazën e sinjalizimeve dhe informacioneve të pranuara nga palë të jashtme.

8. Monitorimi i certifikatave dhe diplomave të lëshuara realizohet në baza vjetore, me paralajmërim ose pa paralajmërim. Ky proces iniciohet sipas detyrës zyrtare nga AKK, përkatësisht nga njësia përgjegjëse për monitorim, ose mbi bazën e sinjalizimeve të jashtme të verifikuara, të cilat evidentojnë parregullsi të mundshme në këtë proces.

9. Afatet e veçanta për secilin lloj të monitorimit, përcaktohen në nenet përkatëse të kësaj rregulloreje.

10. Afatet e përcaktuara në këtë rregullore duhet të zbatohen nga AKK, IAAP dhe të gjitha palët e tjera pjesëmarrëse në procesin e monitorimit. Mosrespektimi i këtyre afateve përbën bazë për paraqitjen e ankesës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11. Në rast se IAAP-të ose institucionet e tjera nuk i respektojnë afatet e përcaktuara në këtë rregullore, konsiderohet se kanë hequr dorë nga ushtrimi i së drejtës ose veprimit që lidhet me afatin përkatës, përveç rasteve kur vonesa arsyetohet në mënyrë të justifikuar dhe pranohet nga AKK.

Neni 10

Monitorimi përmes raportit të vetëvlerësimit dhe planit të përmirësimit

1. Monitorimi i cilësisë së kualifikimeve përmes Raportit të Vetëvlerësimit (RVV) përbën një nga mekanizmat e brendshëm të sigurimit të cilësisë. Ky proces shërben për identifikimin dhe vlerësimin e pikave të forta dhe të dobëta të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) në të gjitha aspektet relevante, përfshirë, por pa u kufizuar në: rolin dhe përgjegjësitë e menaxhmentit, mësimdhënësve/trajnerëve, kualifikimeve dhe moduleve, procesin e mësimdhënies dhe trajnimit, mekanizmat e sigurimit të cilësisë, njohjen e mësimit paraprak (NjMP), si dhe aspektet teknike, përfshirë pajisjet dhe infrastrukturën etj.

2. IAAP-të dhe institucionet e tjera dorëzojnë Raportin e Vetëvlerësimit (RVV) në AKK çdo vit, në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 8, paragrafi 3 të kësaj rregulloreje, duke mbuluar periudhën e vitit kalendarik ose shkollor paraprak. RVV e dorëzuar shqyrtohet dhe analizohet nga njësia e sigurimit të cilësisë. Të gjeturat e njësisë të sigurimit të cilësisë për RVV i dorëzohen njësisë përkatëse të monitorimit.

3. Raporti i Vetëvlerësimit (RVV) përdoret për të vlerësuar nivelin e zbatimit të parimeve dhe indikatorëve (treguesve) të Kornizës Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë (KKSC) nga ofruesit e IAAP-së..

4. Raporti i Vetëvlerësimit (RVV) i dorëzuar nga IAAP përfshin një analizë të pikave të forta dhe të dobëta të institucionit, vlerësimin e efektivitetit të aktiviteteve të tij, si dhe rekomandime të arsyetuara për përmirësim.

5. Njësia përgjegjëse për sigurimit të cilësisë në AKK, analizon dhe vlerëson RVV e dorëzuar dhe konstaton rregullsinë ose parregullsinë e procesit.

6. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit te RVV, njësia përgjegjëse për sigurimit të cilësisë harton një raport njoftues më listë kontrolli për të gjitha institucionet dhe i përcjellët njësisë së monitorimit.

7. Në rast se identifikohen parregullsi, njësia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në AKK përcakton nivelin e tyre, si vijon:

   7.1. Parregullsi të lehta – IAAP-së i jepet një afat deri në 20 (njëzet) ditë pune për korrigjimin e tyre;

   7.2. Parregullsi të rënda – rasti i përcillet pa vonesë njësisë përkatëse të monitorimit për inicimin e vizitës monitoruese në terren.

8. Pas pranimit të raportit vlerësues nga njësia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në AKK, njësia e monitorimit shqyrton të gjitha rastet në të cilat janë identifikuar parregullsi dhe vlerëson se për cilat institucione është e nevojshme të iniciohet procedura e monitorimit, përmes stafit të AKK-së ose ekspertëve të jashtëm, në institucionet përkatëse.

9. Në rast se IAAP-të ose institucionet e tjera nuk dorëzojnë Raportin e Vetëvlerësimit (RVV) brenda afatit të përcaktuar, AKK i njofton me shkrim duke u dhënë një afat shtesë prej 30 (tridhjetë) ditësh për dorëzimin e tij. Nëse edhe pas këtij njoftimi RVV-ja nuk dorëzohet, AKK ndërmerr masat e parashikuara në udhëzimet administrative në fuqi të MASHTI-t, në përputhje me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare.

10. IAAP-të janë të obliguara të përfshijnë vlerësimin e përvojës së kandidatëve ose nxënësve gjatë përgatitjes së Raportit të Vetëvlerësimit, duke përdorur instrumente të përshtatshme, si pyetësorë, fokus-grupe ose intervista. Përfshirja e vlerësimeve dhe reagimeve (feedback-ut) të kandidatëve/nxënësve dhe praktike dhënësve përbën një indikator thelbësor për vlerësimin e cilësisë dhe ndikimit të shërbimeve të ofruara.

Neni 11

Monitorimi nga stafi i AKK

1. Monitorimi përmes vizitës në IAAP organizohet me qëllim të verifikimit të zbatimit dhe përmbushjes së kritereve të përcaktuara nga AKK, në përputhje me kushtet e inicimit të parashikuara në këtë rregullore.

2. Monitorimi i IAAP-ve, përfshirë vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimeve dhe moduleve, realizohet nga njësia përgjegjëse për monitorim në AKK dhe përfshin edhe aspektet e tjera të përcaktuara në këtë rregullore. Në kuadër të këtij monitorimi, verifikohet gjithashtu nëse IAAP i akredituar respekton kriteret e akreditimit dhe përmbush rekomandimet e dhëna nga Paneli i Ekspertëve në Raportin e Akreditimit të institucionit dhe në procesin e validimit të kualifikimeve.

3. Me qëllim të realizimit të procesit të monitorimit përmes stafit të AKK-së, Drejtori i AKK-së nxjerr vendim për monitorim të rregullt me prezencë fizike në IAAP. Në vendim

përcaktohet përbërja e ekipit monitorues, i cili përbëhet nga dy (2) deri në pesë (5) zyrtarë, në varësi të numrit dhe kompleksitetit të kualifikimeve që i nënshtrohen procesit të monitorimit.

4. Zyrtarët që kanë marrë pjesë në monitorimin e një IAAP-je hartojnë raportin e monitorimit, në të cilin evidentojnë të gjeturat nga vizita monitoruese, dhe ia përcjellin atë Drejtorit të AKK-së. Raporti nënshkruhet nga zyrtarët e AKK-së që kanë realizuar monitorimin dhe i dërgohet IAAP-së për paraqitjen e komenteve me shkrim brenda afatit prej 2 (dy) ditësh, sipas kësaj rregulloreje.

5. Në rast se ndonjë nga anëtarët e ekipit monitorues ka vlerësim të ndryshëm nga pjesa tjetër e ekipit, secili anëtar ka të drejtë dhe obligim të paraqesë veçmas tek Drejtori i AKK-së raportin sipas vlerësimit të tij ose të saj.

6. Në rast se gjatë procesit të monitorimit identifikohen shkelje të kritereve të akreditimit ose të validimit të kualifikimeve nga ana e IAAP-së, raporti vlerësues duhet të specifikojë qartë kriteret ose standardet e akreditimit të shkelura, masat dhe hapat përmirësues që duhet të ndërmerren, si dhe afatin kohor për zbatimin e tyre.

7. Afati për zbatimin e rekomandimeve dhe të gjeturave të Ekipit Monitorues përcaktohet nga një (1) deri në tre (3) muaj, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të masave përmirësuese që kërkohen. Në rast të mospajtimit ndërmjet anëtarëve të Ekipit Monitorues lidhur me afatin e përcaktuar, vendimi përfundimtar merret nga Drejtori i AKK-së, bazuar në vlerësimin e kohës së domosdoshme për përmbushjen e rekomandimeve.

8. Gjatë afatit të përcaktuar për zbatimin e rekomandimeve, IAAP-ja është e obliguar t'i dorëzojë AKK-së dëshmitë relevante që konfirmojnë përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Ekipi Monitorues i AKK-së.

9. Në rast se IAAP-ja nuk dorëzon dëshmitë për përmbushjen e rekomandimeve brenda afatit të caktuar, ose kur dëshmitë e dorëzuara kërkojnë verifikim shtesë, realizohet një vizitë e dytë monitoruese në IAAP, me qëllim të konfirmimit të përmbushjes ose mos përmbushjes së rekomandimeve të dala nga vizita e parë monitoruese.

10. Gjatë vizitës së dytë monitoruese, Ekipi Monitorues i AKK-së fokusohet në verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dala nga vizita e parë. Nëse konstatohet se IAAP-ja i ka përmbushur rekomandimet, Ekipi Monitorues harton raport përkatës, me të cilin njofton Drejtorin e AKK-së për përmbushjen e rekomandimeve. Ky raport i paraqitet Këshillit Drejtues të AKK-së për shqyrtim dhe miratim. Drejtorin e AKK-së për përmbushjen e rekomandimeve.

11. Në rast se IAAP-ja dështon të zbatojë përmirësimet e kërkuara nga AKK brenda afateve të përcaktuara në dy proceset paraprake të monitorimit, Ekipi Monitorues i AKK-së harton raport mbi gjendjen faktike lidhur me mos përmbushjen e rekomandimeve dhe ia dorëzon atë Drejtorit të AKK-së. Drejtori i AKK-së e përcjell raportin përkatës Këshillit Drejtues të AKK-së për shqyrtim dhe vendimmarrje.

Neni 12
Monitorimi përmes ekspertëve të jashtëm

1. Procesi i monitorimit përmes ekspertëve të jashtëm iniciohet nga Njësia e Monitorimit e AKK-së, në përputhje me kriteret e monitorimit të përcaktuara në këtë rregullore, në rastet kur konstatohet mos përmbushja e kushteve, kritereve dhe rekomandimeve që dalin nga procesi i akreditimit dhe validimit nga ana e IAAP-ve dhe institucioneve të tjera.

2. Monitorimi përmes ekspertëve të jashtëm mund të realizohet me paralajmërim ose pa paralajmërim, me qëllim të vlerësimit të përmbushjes së kushteve të akreditimit dhe validimit, në rastet kur vërehet se devijimet nga kriteret dhe kushtet përkatëse janë të natyrës serioze.

3. Ekipi i Ekspertëve të Jashtëm, në rastet e monitorimit të jashtëzakonshëm, përbëhet nga tre (3) anëtarë për kualifikimin e fushës përkatëse. Në rastet e tjera të monitorimit përmes ekspertëve të jashtëm, monitorimi mund të realizohet edhe me dy (2) anëtarë. Në përbërjen e ekipit përfshihet detyrimisht një ekspert i sigurimit të cilësisë.

4. Ekipi i Ekspertëve të Jashtëm përbëhet nga ekspertë profesionistë që përfaqësojnë fushën ose sektorin përkatës të kualifikimit, si dhe nga një përfaqësues i AKK-së në cilësinë e koordinatorit të procesit. Para fillimit të angazhimit, të gjithë ekspertët e jashtëm janë të obliguar të nënshkruajnë deklaratë për mos konflikt interesi dhe konfidencialitet.

5. Me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së procesit, rekomandohet që në përbërjen e Ekipit të Ekspertëve të Jashtëm të përfshihet të paktën një anëtar që ka marrë pjesë më parë në procesin e vlerësimit për akreditimin e institucionit ose në validimin e kualifikimeve të IAAP-it përkatës. Në rast se kjo nuk është e mundur, AKK siguron transferimin e plotë të informacionit dhe dokumentacionit relevant tek ekipi i ri i ekspertëve.

6. Gjatë vizitës monitoruese, Ekipi i Ekspertëve të Jashtëm shqyrton të gjeturat nga vizita aktuale, si dhe nga vizitat monitoruese të mëhershme të realizuara nga zyrtarët e AKK-së në IAAP-në përkatëse, dhe i krahason ato me rekomandimet e dhëna nga ekipi i ekspertëve që ka realizuar akreditimin e institucionit dhe validimin e kualifikimeve.

7. Pas përfundimit të vizitës, Ekipi i Ekspertëve të Jashtëm harton raportin e monitorimit, i cili përmban gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti i përcillet Drejtorit të AKK-së nga zyrtari përgjegjës për monitorim, me qëllim që t'i dërgohet Këshillit Drejtues të AKK-së për vendimmarrje përfundimtare. Para paraqitjes në Këshillin Drejtues, raporti i dërgohet IAAP-së përkatëse për komente, e cila ka afat pesë (5) ditë për të paraqitur komente dhe dëshmi lidhur me konstatimet e raportit.

8. Në rast se gjatë vizitës së jashtëzakonshme për monitorim konstatohet se IAAP-ja ka ndërmarrë dhe zbatuar përmirësimet e kërkuara më herët, si dhe përmbush kriteret dhe rekomandimet e akreditimit dhe validimit, Ekipi i Ekspertëve të Jashtëm harton raportin përkatës me gjetjet.

9. Në rast se gjatë vizitës së jashtëzakonshme Ekipi i Ekspertëve të Jashtëm konstaton shkelje të kritereve të akreditimit dhe mos përmbushje të rekomandimeve sipas planit të

përmirësimit të paraqitur nga IAAP-ja, Këshilli Drejtues i AKK-së, në përputhje me udhëzimet administrative në fuqi, merr vendim për revokimin e akreditimit të institucionit dhe validimit të kualifikimeve që kanë qenë objekt i monitorimit në IAAP.

10. Raporti i monitorimit i hartuar nga Ekipi i Ekspertëve të Jashtëm i përcillet Këshillit Drejtues të AKK-së për shqyrtim dhe miratim përmes Drejtorit të AKK-së.

11. Pas përfundimit të procesit të monitorimit, pavarësisht nëse raporti përcjellët për miratim në KD AKK, duhet të nxjerrët një vendim nga KD AKK, kur raportet dërgohen për miratim ose nga Drejtori i AKK, kur raportet e monitorimit nuk dërgohen në KD AKK për miratim. Vendimi i përcjellët IAAP ose institucionit tjetër që është monitoruar, duke përfshirë edhe këshillën juridike.

Neni 13

Angazhimi i ekspertëve të jashtëm në procesin e monitorimit

1. Për procesin e monitorimit të jashtëzakonshëm, AKK angazhon ekspertë të jashtëm të aprovuar nga Këshilli Drejtues, nga lista e hapur e ekspertëve për akreditim/riakreditim dhe validim/rivalidim. Angazhimi i ekspertëve realizohet përmes kontratave për shërbime të veçanta, ndërsa kostoja financiare e këtij angazhimi mbulohet nga AKK.

2. Vendimin për angazhimin e ekspertëve të jashtëm e nxjerr Drejtori i AKK-së, pas rekomandimit të njësisë përkatëse për monitorim. Rekomandohet që në procesin e monitorimit të përfshihen ekspertët që kanë marrë pjesë në vizitën e akreditimit ose ri akreditimit të institucionit apo kualifikimit përkatës. Vetëm në raste të veçanta, kur monitorimi përfshin më shumë kualifikime ose kërkon ekspertizë shtesë, mund të angazhohet edhe ekspert tjetër që nuk ka qenë pjesë e procesit paraprak të akreditimit ose ri akreditimit.

3. Angazhimi i ekspertëve të jashtëm realizohet për një periudhë prej dy (2) ditësh pune, kur ekspertët e angazhuar janë të njëjtë me ata që kanë marrë pjesë në procesin e akreditimit ose ri akreditimit. Në rastet kur, për shkak të nevojave të monitorimit, angazhohen ekspertë të ndryshëm, periudha e angazhimit mund të zgjatet deri në tre (3) ditë pune.

Neni 14

Monitorimi i certifikatave/diplomave të lëshuara nga IAAP

1. Me qëllim të garantimit të vlefshmërisë ligjore dhe cilësisë së kualifikimeve, të gjitha certifikatat dhe diplomat e lëshuara nga IAAP-të për kualifikimet e përfshira në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve verifikohen dhe vulosen nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), në përputhje me nenin 15, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare.

2. IAAP-të janë të obliguara ta informojnë AKK-në, me shkrim, për listën e kandidatëve të grupeve të formuara para fillimit të procesit të trajnimit. Pas dhënies së akreditimit, AKK i dërgon IAAP-së njoftim zyrtar për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm, si vijon::

2.1.listën e grupeve të nxënësve/kandidatëve, e plotësuar sipas formatit të bashkëngjitur;

2.2.listën e stafit mësimdhënës të deklaruar, e plotësuar sipas formatit të bashkëngjitur;

2.3.planin e ofrimit të kualifikimit me ndërlidhjen e moduleve, i cili përfshin ndarjen e orëve sipas ditës, javës, muajit dhe vitit, për secilin grup dhe listë të dorëzuar në AKK.

3. Afatet për deklarim në IAAP, përcaktohen si në vijim:

   3.1. Për Kualifikimet Kombëtare Profesionale, afati i deklarimit për kualifikimet e niveleve 1–5 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) është brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditësh nga fillimi i procesit mësimor;
   3.2. Për Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (Shkollat Profesionale), afati i deklarimit për kualifikimet e niveleve 1–5 të KKK-së është brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga fillimi i procesit mësimor;
   3.3. Për kualifikimet e bazuara në standarde ndërkombëtare, afati i deklarimit për kualifikimet e niveleve 1–5 të KKK-së është brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditësh nga fillimi i procesit mësimor;
   3.4. Për kurset e gjuhëve të huaja, sipas Kornizës Evropiane të Përbashkët të Gjuhëve (KEPGj), afati i deklarimit është brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga fillimi i procesit mësimor;
   3.5. Për kualifikimet me kohëzgjatje më të shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë, deklarimi bëhet para fillimit të trajnimit përkatës, përpara se grupet të nisin zhvillimin e trajnimit.

4. Të gjithë kandidatët që pajisen me diploma ose certifikata nga IAAP-të duhet të jenë të përfshirë në listat e kandidatëve të regjistruar, në përputhje me kuotat e lejuara dhe të miratuara me vendimin për akreditimin e institucionit, përkatësisht me vendimin për validimin e kualifikimeve.
5. Në rast se zyrtari kompetent i AKK-së, gjatë procesit të verifikimit dhe vulosjes së diplomave ose certifikatave, konstaton parregullsi në formatin e dokumentit, në të dhënat e institucionit, kualifikimit apo në të dhënat personale të kandidatit, këto parregullsi evidentohen dhe i përcillen njësisë përkatëse të monitorimit në AKK. Njësia e monitorimit verifikon të dhënat përkatëse dhe harton raport me të gjeturat, të cilin ia përcjell Drejtorit të AKK-së. Raporti i dërgohet edhe IAAP-së për korrigjimin e parregullsive brenda një afati prej së paku një (1) dhe më së shumti dy (2) muajsh.
6. Diplomat dhe certifikatat nuk verifikohen dhe nuk vulosen në rast se listat e kandidatëve dhe plani i ofrimit mësimor nuk janë deklaruar brenda afateve të përcaktuara.
7. Diplomat ose certifikatat që përmbajnë gabime të karakterit teknik, përfshirë por pa u kufizuar në datën, vendin e lëshimit, numrin e kredive ose të dhëna të ngjashme, nuk vulosen dhe nuk vërtetohen deri në përmirësimin e plotë të këtyre gabimeve.
8. Institucionet që aplikojnë për akreditim për herë të parë nuk mund të fillojnë regjistrimin e grupeve ose lëshimin e certifikatave/diplomave deri në marrjen e vendimit nga Kryetari i Bordit (KD), pas përfundimit të procesit të akreditimit.
9. Të gjitha institucionet, të cilave u skadon periudha e akreditimit/validimit, riakreditimit ose rivalidimit, nuk mund të regjistrojnë grupe të reja dhe nuk mund të lëshojnë certifikata ose diploma deri në marrjen e vendimit të ri për riakreditim/rivalidim.

10. Institucioni është i obliguar të aplikojë për riakreditim/rivalidim së paku një vit përpara skadimit të periudhës së akreditimit/validimit, në përputhje me aktet përkatëse të AKK-së.
11. AKK-ja është e detyruar që, brenda afateve ligjore, të shqyrtojë aplikacionet dhe të marrë vendim lidhur me riakreditimin/rivalidimin e institucionit, para përfundimit të periudhës së akreditimit/riakreditimit që të ruhet vazhdimësia e akreditimit.
12. Në rast se diplomat ose certifikatat e lëshuara nga IAAP-të përmbajnë të dhëna që janë në kundërshtim me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, udhëzimet administrative në fuqi ose vendimet e AKK-së, zyrtarët e AKK-së hartojnë raport përkatës dhe e informojnë Drejtorin e AKK-së. Në këto raste, kërkohet formimi i Ekipit për Monitorim me prezencë fizike në institucion, nga njësia përkatëse e monitorimit në AKK. Në rast të humbjes apo dëmtimit të certifikatës, procedurat për lëshimin e certifikatave duplikat rregullohen nga aktet e brendshme të institucioneve përkatëse, për të cilat duhet të informohet AKK.
13. Në rast se konstatohet se diplomat ose certifikatat janë lëshuar për persona që nuk i kanë përmbushur kriteret e regjistrimit, ose emrat e të cilëve nuk figurojnë në listat e dorëzuara nga IAAP-të në AKK, njësia përgjegjëse për monitorim inicion procedurën për anulimin e këtyre diplomave ose certifikatave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 15
Veprimet e AKK pas procesit të monitorimit

1. AKK realizon procesin e monitorimit me qëllim që të krijojë mundësi për përmirësimin dhe avancimin e vazhdueshëm të kushteve të akreditimit dhe validimit, si dhe të parametrave të sigurimit të cilësisë në IAAP.
2. Pas përfundimit të procesit të monitorimit, AKK, në çdo rast, i siguron IAAP-së mundësinë për të ndërmarrë masa përmirësuese, bazuar në të gjeturat dhe rekomandimet e raportit monitorues. Varësisht nga niveli i zbatimit ose moszbatimit të këtyre rekomandimeve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në kushtet e akreditimit dhe validimit, AKK mund të iniciojë edhe procedurën për revokimin e akreditimit dhe validimit.
3. Procesi i revokimit të akreditimit dhe validimit mund të iniciohet në çdo kohë, në përputhje me udhëzimet administrative në fuqi, në rastet kur IAAP:
   3.1. dështon të dorëzojë Raportin e Vetëvlerësimit (RVV) edhe pas përsëritjes së afatit të përcaktuar;
   3.2. paraqet të dhëna ose dokumente të pasakta, të pavërteta ose mashtruese;
   3.3. dështon të përmbushë rekomandimet e dala nga procesi i monitorimit, dështim ky i dokumentuar përmes raportit përkatës.
4. Vendimi për revokimin e akreditimit dhe validimit merret nga Këshilli Drejtues i AKK-së, bazuar në gjetjet e proceseve të monitorimit dhe pas sigurimit të së drejtës së IAAP-së për t'u dëgjuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Secili proces i monitorimit përmbyllet me një akt zyrtar, respektivisht vendim, i cili bazohet në raportet e monitorimit. Vendimi mund të nxjerret nga KD AKK, në rastet kur raportet duhet të dërgohen në KD AKK për miratim ose drejtori i AKK në rastet kur raportet dërgohen tek drejtori i AKK. Vendimi i dërgohet institucionit që i është nënshtruar procesit të monitorimit.

Neni 16
Ankesa ndaj vendimit për procesin e monitorimit

1. Në rast se pala, përkatësisht IAAP-ja, nuk është e kënaqur me vendimin e Këshillit Drejtues të AKK-së apo drejtorit të AKK, ka të drejtë të parashtrojë ankesë brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të vendimit, në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
2. Ankesa parashtrohet pranë Këshillit Drejtues të AKK-së, në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, IAAP-së i garantohet e drejta për t'u dëgjuar, në përputhje me nenin 95 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe e drejta për të paraqitur prova dhe dokumentacion shtesë, nëse ka.

Neni 17
Përshtatshmëria e zbatimit të procedurave të monitorimit

1. Kjo rregullore, përveç zbatimit të saj në procedurat e monitorimit për IAAP-të, kualifikimet e të cilave akreditohen dhe validohen nga AKK, zbatohet përshtatshmërish t edhe në procesin e monitorimit të IAAP-ve që ofrojnë njohjen e mësimit paraprak (NJMP).
2. Në rastet kur kjo rregullore nuk përcakton afate ose rregulla të veçanta procedurale, zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative në fuqi.

Neni 18
Formatet e raporteve të monitorimit

1. Formatet e raporteve të monitorimit dhe lista e kontrollit që përdoren në procesin e monitorimit janë pjesë përbërëse e Shtojcës 1 të kësaj rregulloreje.
2. Shtojca 1 e kësaj rregulloreje është pjesë përbërëse e rregullores dhe zbatohet njëjtë sikurse pjesa e dispozitave të tjera. Shtojca 1 e kësaj rregulloreje përfshin:
   2.1. Model Raporti Monitorimit nga stafi i AKK;
   2.2. Model Raporti i Monitorimit të jashtëzakonshëm nga ekspertët për monitorim pas akreditimit;
   2.3. Lista për deklarimin e kandidatëve/nxënësve;
   2.4. Lista për deklarimin e trajnerëve/mësimdhënësve;
   2.5. Planin e ofrimit të kualifikimit – përfshirë ndarjen e orëve sipas ditës, javës, muajit dhe vitit, për çdo listë të dorëzuar në AKK (format i Institucionit).
   2.6. Lista përfundimtare e kandidateve-nxënësve

Neni 19
Dispozitat kalimtare dhe hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore do të fillojë së zbatuari nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi.
2. Periudha kalimtare prej tre (3) muajsh shërben për informimin e IAAP-ve dhe AKK-së lidhur me procedurat, kriteret dhe obligimet që do të zbatohen gjatë procesit të monitorimit, në përputhje me këtë rregullore.
3. Gjatë periudhës kalimtare, AKK ndërmerr të gjitha përgatitjet e nevojshme administrative, organizative dhe teknike për zbatimin efektiv të kësaj rregulloreje.
4. Deri në fillimin e zbatimit të kësaj rregulloreje, të gjitha IAAP dhe institucionet e tjera, të cilët kanë aplikuar për akreditim/ri akreditim, por shqyrtimi i aplikacionit nuk është bërë pa fajin e IAAP ose institucionit tjetër që ka aplikuar, ndërkaq që IAAP kanë filluar realizimin e grupeve dhe i kanë deklaruar ato në AKK, diplomat ose certifikatat për këto grupe vulosen nga AKK, me kusht që IAAP ose institucioni tjetër fiton akreditim ose ri akreditim me vendim të AKK, në bazë të aplikacionit.

Neni 20
Dispozita shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha dispozitat e nivelit të njëjtë juridik që rregullojnë të njëjtën materie. Evidentimi i akteve dhe dispozitave që shfuqizohen bëhet nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve gjatë periudhës kalimtare.

z. Naim Gashi

Zv.Drejtor i AKK

Data 05 . 01 . 2022